



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 26-09-2025
Nr. 2/2266

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4 dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë dhe Udhëzimit administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të arsimit të lartë në Kosovë, kërkesa nr. 5-2266 e datës 17.06.2025 e parashtruar nga BPrAL- Kolegji internacional “FAMA”, nxjerr:

V E N D I M
Për licencimin e Kolegjit internacional “FAMA”

1. Bartësi privat i arsimit të lartë / Kolegji internacional “FAMA” në Prishtinë, në nivel Institucional licenohet për periudhën trevjeçare 2025-2028 (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028),
2. Bartësi privat i arsimit të lartë/Kolegji internacional Fama në Prishtinë, licenohet për periudhën trevjeçare (1 tetor 2025 - 30 shtator 2028), për programet e studimit:
 - 2.1. Juridik i përgjithshëm, LLB 240 ECTS (A) me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;
 - 2.2. Përkujdesje dhe mirëqenie social BA 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik;
 - 2.3. Shkenca kompjuterike, BSC 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 100 studentë për vit akademik.
 - 2.4. Menaxhim dhe ekonomi BSc (Ekonomi e përgjithshme), 180 ECTS (A) me kuotën maksimumi 150 studentë për vit akademik.
3. Bartësi privat i arsimit të lartë, Kolegjit internacional “FAMA” në Prishtinë, sipas paragrafit 1 të këtij vendimi, mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim ose tejkalim të këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, ka shqyrtuar kërkesën me nr. 5-2266 të datës 17.06.2025 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji internacional "FAMA" dhe vendimeve të Agjencionit të Kosovës për Akreditim me nr. ref. 103/25 datë: 10.02.2025 dhe 450/25 e dt. 23.04.2025.

Licenca e Kolegjit FAMA zgjat sipas dispozitivit të këtij vendimi si në nivel institucional dhe të programeve të studimit duke u bazuar në vendimet e nxjerra nga AKA.

Komisioni për Licencim dhe rilicencim në MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin për aplikim, kërkon nga Kolegji Internacional FAMA që brenda vitit kalendarik deri më 01 shtator 2026 të ofroj lejen e legalizimit dhe vendimin për ndryshim të destinacionit nga ai afarist në veprimtari arsimore nga organi kompetent, Drejtoria e Urbanizmit - Komuna e Prishtinës.

Nëse brenda vitit kalendarik nuk dorëzohet leja e legalizimit të objektit dhe vendimin për ndryshimin e destinacionit brenda datës 01.09.2026, Kolegjit Internacional "FAMA me qendër në Prishtinë, nuk i lejohet regjistrimi i studentëve për vitin akademik 2026/2027.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit internacional "FAMA";
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm/MASHTI;
4. DALSH;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA;
7. Arkivit.



Kryetar i Komisionit

Burim Gashi